



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS GLLOGOC

Numri i lëndës: 2023:281330

Datë: 31.01.2024

Numri i dokumentit: 05263168

PPP. nr. 85/2023

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEGA NË GLLOGOC Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Astrit Gashi me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Remzi Duli, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit I... J.S.S me seli në Prishtinë, kundër debitorit Z.K nga Komuna e Gllogocit, të cilin e përfaqëson I.Sh, lidhur me borxhin në vlerë prej 575.76 €, duke vendosur në prapësimin e ushtruar nga debitori, kundër urdhërit për lejimin e përmbartimit të Përmbartuesit B.T, P. nr... të datës 23.11.2023, jashtë seancës me datën 29.01.2024 e mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET në tërësi si i bazuar** prapësimi i debitorit Z.K nga Komuna e Gllogocit ushtruar kundër urdhërit të përmbartuesit Privat B.T nga Ferizaj, nën shenjën P. nr... të datës 23.11.2023.
- II. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar** propozimi i kreditorit I... J.S.S me seli në Prishtinë, të datës 04.10.2021 sa i përket borxhit/kërkesës në shumën prej **243.55 €**, ashtu që Urdhëri i përmbartuesit privat B.T nën shenjën P.nr... i datës 23.11.2023 **SHFUQIZOHET.**

ARSYETIM

Kreditori I... J.S.S me seli në Prishtinë ka parashtuar propozim tek Përmbartuesi Privat B.T, për lejimin e përmbartimit në bazë të dokumentit të besueshëm - Marrëveshja mbi kredinë nr... e datës 25.01.2019 lidhur me pagesën e kredisë-borxhit kryesor në lartësi prej 575.76 €, si dhe shpenzimet e procedurës, të gjitha këto në afat 7 ditor në të kundërtën, të bllokohen llogaritë bankare të debitorit, e nëse nuk ka mjete në llogari të bëhet regjistrimi, sekuestrimi, vlerësimi dhe shitja e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme e mjetet e mbledhura të derdhen në llogari të kreditorit.

Përmbauesi Privat, duke vepruar sipas propozimit për përmbauesim të kreditorit, ka lëshuar urdhër P. nr... të datës 23.11.2023 me të cilin ka lejuar përmbauesimin në bazë dokumentit të besueshëm - Marrëveshja mbi kredinë nr... e datës 25.01.2019.

Debitori ka paraqitur prapësim kundër urdhërit për lejimin e përmbauesimit në afatin ligjor, arsyetimin se duke u bazuar në dispozitat ligjore në kuptim të normave nga e drejta materiale konsiderojnë se ka të bëjë me parashkrimin e kërkesës dhe atë në kuptim të Nenit 341 par. 1.2, 342, 305 dhe 353 të LMD-së, po ashtu propozimi për përmbauesim është i pa vlefshëm për shkak se është lejuar në kundërshtim me Nenin 38 par. 1 se dokumenti me të cilën është kërkuar përmbauesimi nuk është origjinal dhe si njëjti do të duhej të ishte vërtetuar pranë zyrës së ndonjë organi publik, andaj ka kërkuar që në vështrim të Nenit 73 par.1 të LPP-së të aprovet si i bazuar prapësimi i tij dhe të refuzohet si i pa bazuar urdhëri për përmbauesim i përmbauesit privat. Kreditori në afatin ligjor ka paraqitur përgjigje në prapësim duke kundërshtuar prapësimin e debitorit në tërësi si të pa bazuar dhe të pa argumentuar me asnjë provë, andaj i ka propozuar gjykatës që të refuzoj prapësimin e debitorit dhe urdhëri P. nr... i datës 23.11.2023 të mbetet në fuqi.

Gjykata ka shqyrtuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar, ndërsa propozimin e kreditorit dhe urdhërin e dhënë nga përmbauesi privat, gjykata i konsideroi si të pa qëndrueshme dhe atë për këto arsye.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit në prapësim, propozimit për përmbauesim dhe analizimit të shkresave tjera të lëndës ka ardhur në përfundim se përmbauesimi në këtë çështje përmbauesimore është caktuar në kundërshtim me dispozitat ligjore pasi që kemi të bëjmë me parashkrim duke u bazuar në Nenin 341 par. 1 të LMD-së, i cili nen përcakton se “*Me parashkrim shuhet e drejta e kërimit të përmbushjes së detyrimit. Ndërsa në par. 2 ceket se “Parashkrimi krijohet kur të ketë kaluar afati i caktuar me ligj, brenda të cilit kreditori ka mundur të kërkojë përmbushjen e detyrimit”, që do të thotë se kreditori ka paraqitur propozimin për përmbauesim pasi që ka kaluar koha e paraparë ku kreditori ka pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e obligimit nga debitori.*

Po ashtu në bazë të Nenit 342 par. 1 të LMD-së që përcakton se “*Parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë pas ditës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit, në qoftë se me ligj për raste të veçanta nuk është parashikuar diçka tjetër*”, e në rastin konkret si ditë e fillimit të parashkrimit është data 03.08.2020 pasi që kreditori dhe debitori kanë nënshkruar një kontratë specifike të huasë personale me nr..., ku është specifikuar se kësti i fundit për pagesë ka qenë me datën 03.08.2020 dhe fillimi i parashkrimit ka rrjedh të nesermën me datën 04.08.2020 ndërsa kreditori e ka paraqit propozimin për përmbauesim pas tre viteve dhe atë me datën 23.11.2023, përkatësisht pas 3 vite e tre muaj e 19 ditë.

Gjykata vendosi si në dispozitiv duke u bazuar në Nenin 353 par. 1 të LMD-së që përcakton se “*Kërkesat e dhënieve periodike që rrjedhin vit për vit ose në afate të caktuara më të shkurtëra (kërkesat periodike), qofshin ato kërkesa periodike aksesore, siç janë kërkesat e kamatës, apo kërkesa periodike të atilla në të cilat përfundon vetë e drejta, siç janë kërkesat e ushqimit, parashkruhen tri (3) vjet nga arritja e secilës dhënie të veçantë për pagesë*”, e në rastin konkret kreditori nuk ka ofruar asnjë provë materiale me të cilën do të bënte të besueshme se është ndërprerë parashkrimi i së drejtës së kërkesës së kreditorit për përmbushjen e borxhit nga debitori sipas Nenit 353 par. 1 të LMD-së, dhe Nenit 368 të LMD-së që në par. 1 përcakton se “*parashkrimi ndërpritet kur debitori e pranon borxhin*”.

Gjykata gjendjen faktike të konstatuar si më lartë, erdhi në përfundim se përmbarimi në këtë çështje përmbarimore është caktuar pa plotësuar kushtet ligjore për nxjerrjen e urdhërit përmbarimor të paraparë me dispozitat e lartëcekura të LPP-së dhe LMD-së për faktin se, Kontrata e huasë mbi bazën e të cilës është ushtruar propozimi për përmbarim, është i pa bazuar për përmbarim dhe nuk qëndron ligjërisht pasi që kemi të bëjmë me parashkrim në bazë të dispozitave të lartëcekura, dhe se kreditori ka lëshuar afatet ligjore të cilat janë të parapara me Ligjin për Marrëdhënie të Detyrimeve si më lartë.

Debitori në prapësimin e tij ka pretenduar se nuk ka obligim ndaj Kreditorit pasi që pretendon se kemi të bëjmë me parashkrim.

Gjykata aprovoj pretendimet e debitorit pasi që e gjeti si të bazuar, ndërsa kreditori në anën tjetër, propozimit për përmbarim i ka bashkangjitur dokumentin e besueshëm Kontratën e Huasë me nr... të datës 25.01.2019 i cili i plotëson kushtet ligjore për të u trajtuar dokument i besueshëm në kuptim të Nenit 29 pika 1.3 të LPP-së, mirëpo gjykata gjeti se kërkesa e kreditorit është parashkruar dhe nuk ka bazë ligjore për të aprovuar pretendimet e kreditorit të dhëna në përgjigjen në prapësim ku thotë se debitori ka bërë disa herë pagesa, mirëpo i njëjti nuk ka bashkangjitur asnjë dëshmi fature me të cilën do të argumentonte se ka ndërprerje të parashkrimit nga ana e debitorit.

Nga të lartëcekurat si me lartë gjykata duke u bazuar në Nenin 73 par. 3 të LPP-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË GLLOGOC
Departamenti i Përgjithshëm, PPP. nr. 85/23 i datës 29.01.2024

Gj y q t a r i
Astrit Gashi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.

Ankesa e ushtruar kundër këtij aktvendimi nuk e ndalon procedurën përmbarimore përveç nëse janë dhënë garancitë për shumën e plotë të kredisë sipas Nenit 78 të LPP-së.